

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit MSc në Inxhinieri Mekatronikë
Universiteti Privat "Albanian University"

Eksperti i vlerësimit të jashtëm: **Prof.As.Dr. Mimoza Dhrami (Cukalla)**



(Qershor/2017)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër MASH Nr.488, datë 4.10.2011
4	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike
5	Cikli i studimit:	Cikli i II
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Ofrohet nga AU
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2015-2016
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2016-2017
17	Nr i studentëve: 2015-2016 2016-2017	10 Studentë 17 Studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Albanian University e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të akteve të tjera nënligjore, si Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit.

Albanian University fillimisht është institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë i njohur si Shkollë Universitare me VKM nr.197, datë 10.04.2004. Albanian University është person juridik privat. Emri i dhe status i institucionit është ndërruar nga “**UFO University**” në “**Albanian University**” me VKM nr.603, datë 24.03.2011.

Albanian University, aktualisht pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore: **Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike**. Ai ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njëjve përbërëse kryesore, bazë dhe ndihmëse.

Programi i studimit **Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”** në Albanian University, është licensuar me urdhër Nr.488, datë 04.10.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me kusht që brenda gjashtë muajve të paraqiteshin në Ministri plotësimet e kushteve të vendosura nga KA: a) të plotësohet personeli akademik; b) të vendos raport të balancuar midis fushave bazë të formimit: mekanikës, elektronikës, elektroteknikës, informatikës. Deri tani nuk ka asnjë informacion zyrtar nga institucioni për plotësimin e këtyre kushteve. Ky program studimi organizohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike nën përgjegjësinë e departamentit të Inxhinierive. Programi i studimit është bërë aktiv për herë të parë në vitin akademik 2015-2016.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Prof.As Mimoza Dhrami (Cukalla) si eksperte e jashtme e vlerësimit të këtij programi studimi. Gjatë gjithë procedurës, GVJ është asistuar nga specialisti i nga specialistia e ASCAL Znj. Xhiliola Bixheku.

Në datën 06.06.2017 dërgohet në institucion Draf RVJ. Në datën 13.06.2017 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draf RVJ-në. Këto komente ju përcollën ekspertit, nga të cilat u mor parasysh vetëm komentin Nr. 4.

Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike ka për qëllim të realizojë përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e Mekatronikës. Të diplomuarit në të këtë program studimi marrin njohuri të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre:

- a. për të zhvilluar veprimtarinë në institucione publike dhe private në kuadër të sistemeve mekatronike të aplikuara;
- b. për të zhvilluar veprimtarinë e drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të pajisjeve mekatronike, si dhe projektimin dhe realizimin e sistemeve mekatronike;
- c. pas një periudhe praktike në profesion dhe studimeve të avancuara, aftësinë për të drejtuar kualifikimin dhe përgatitjen e teknikëve dhe profesionistëve të ardhshëm në këtë fushë.

Gjatë periudhës së studimit, studenti merren bazat e nevojshme dhe të thelluara në disiplina të ndryshme dhe fiton kompetenca më specifike mbi tema e drejtime më të profilizuara, gjë e cila u krijon mundësinë studentëve të marrin njohuri më të plota në fushën përkatëse. Kurrikula e këtij programi **ka në bazë lidhjen e teorisë me praktikën laboratorike**. Kjo ndihmon në një integrim më të lehtë të studentit në tregun e punës.

Qëllimet dhe objektivat e këtij program studimi janë në përputhje me misionin e Albanian University, e shprehur në "Planin Strategjik të Zhvillimit institucional 2017-2022". Në këtë plan strategjik shprehet angazhimi i institucionit për të përmirësuar programet e studimit, për të rritur cilësinë e mësimdhënjes nëpërmjet trajnimeve të stafit akademik, rritjes së stafit akademik në numër dhe në kualifikim, sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe krijimi i strukturave të brendshme për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë në mësimdhënje.

Në planin strategjik të zhvillimit të institucionit, Kërkimi shkencor orientohet drejt realizimit të disa synimeve:

Së pari, në funksion të mësimdhënies, duke synuar në rritjen e cilësisë së arsimimit nëpërmjet integrimit të kërkimit me mësimin. Në këtë drejtim synohet t'u jepet studentëve aftësi metodologjike për kërkim, dhënjën e njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, përmirësimin e kualifikimit të personelit akademik si dhe krijimin e mjeteve materiale për zhvillimin dhe punën në institucion.

Së dyti, në përshtatje të ofertës universitare me nevojat e tregut të punës, duke synuar në realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese në mënyrën e përcaktuar në statutin e Albanian University, sipas objektivave specifike të institucionit në këto drejtime.

Së treti, në shërbime për të tretët, duke synuar dhënjën e shërbimeve të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime servisi, informacioni e të tjera.


Objektivat strategjike për realizimin e misionit të Universitetit në pesë vitet e ardhshme janë përcaktuar në drejtimet e mëposhtme:

1. Organizimi Institucional;
2. Mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënja e fokusuar drejt formimit të studentëve;
3. Kërkimi shkencor dhe Inovacioni;
4. Sigurimi i brendshëm i cilësisë;
5. Veprimtaritë shërbyese;
6. Marrëdhëniet me jashtë.

Nëpërmjet këtyre objektivave strategjike synohet të realizohet lidhja e drejtpërdrejtë e programeve të studimit me praktikën dhe tregun e punës. Për këtë arsye programet e studimit i nënshtrohen një përditësimi të vazhdueshëm, duke iu përshtatur arritjeve të shkencës dhe kërkesave të tregut të punës. Departamenti i Inxhinierive rishikon çdo vit syllabuset për programet e studimit që mbulon. Në zbatim të objektivave strategjike për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave, mësimdhënjes dhe mësimnxënjes, departamenti i inxhinjerive është përfshirë në rishikimin e programeve të studimit që mbulon.

Në kuadër të zgjerimit të tij, departamenti parashikon hapjen e programit Master i Shkencave/ Master Profesional në Inxhinieri Elektrike. Në bazë të kërkesave të tregut, mbetet e hapur mundësia e hapjes së programeve Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike.

Në kuadër të bashkëpunimeve institucionale të Universitetit, me **Universitetin e Corvinus, Budapest Hungari**, me **Universitetin e L'aquilas**, me **Universitetin Ningbo Dahongying Kinë**, departamenti synon të përfshijë në mësimdhënje pedagogë të këtyre universiteteve, fillimisht në nivel *Master* dhe më vonë në nivel *Doktorature*, të kryejë trajnimin e stafit të brendshëm pranë tyre,



të realizojë praktika të studentëve në bashkëpunim me ta, si dhe të realizohet pjesëmarrja si partnerë në projekte të ndryshme evropiane në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, në kuadër të programeve Erasmus+.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Kriteri 3. Programi i studimit MSc në “Inxhinieri Mekatronike”, e mbështetur nga Departamenti i Inxhinierive, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, është në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e <i>Albanian University</i>. Përmes lidhjes së teorisë me praktikën laboratorike synohet në formimin e studentit në MSc “Inxhinieri mekatronike”, në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Kriteri 4. Programi i studimit MSc në “Inxhinieri Mekatronike”, përputhet me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Kriteri 5. Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Kriteri 6. Ky program studimi kontribuon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare përmes punimeve shkencore të stafit dhe studentëve të tij.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Kriteri 1. Programi i studimit MSc në “Inxhinieri Mekatronike” është në përshtatje me Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>Kriteri 1. Përmbajtja e programit të studimit “MSc në Inxhinieri Mekatronike” është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi i studimit është me 120 ECTS, nga të cilat 30 ECTS janë diplomë. Organizimi i disiplinave sipas formimit që sigurojnë: të përgjithshëm, karakterizues, integruar, formues, me zgjedhje është në përputhje me udhëzimet e ministrisë. Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm për zbatimin e tyre. Aktivitetet formuese të lëndëve</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

<p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>përmbajnë leksione, ushtrime/ seminare, laboratore, detyra. Ka kritere të brendshme të kthimit të kreditit në orë në auditor. Programi i studimit shoqërohet nga rregullorja e studimit, e cila përmban elementët e nevojshëm për organizimin e procesit mësimor. Janë të hartuara modelet e diplomës dhe suplementi i diplomës.</p> <p>Kriteri 2. Emërtimi i programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike” është në përputhje me nivelin e kualifikimit (7) të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Kriteri 1. Albanian University ka një plan strategjik të zhvillimit institucional, në të cilin shprehen ndërmjet të tjerave edhe objektivat për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Në planin strategjik të hartuar, një vend të rrëndësishëm zë përmirësimi i rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Përmes vlerësimit të brendshëm të cilësisë, Institucioni synon të evidentojë pikat e dobëta dhe të marrë masat për përmirësimin e punës së tij. Një drejtim është puna që bëhet për kualifikimin e stafit akademik dhe trajnimin e tyre për aplikimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie. Drejtim tjetër është fuqizimi i bazës laboratorike, nëpërmjet të cilës synohet të bëhet lidhja e teorisë me praktikën, e cila ndikon në përmirësimin e rezultateve të të nxënit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike”, hartuar nga Albanian University, është hartuar në përputhje me misionin e tij, planin strategjik të zhvillimit dhe nevojat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucioni punon vazhdimisht në zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve, si dhe në përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> <p>Standardet I.1, I.2, I.3, I.11 plotësohen tërësisht.</p>	

Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit të studimit i referohet te dhënave për vitin akademik 2015-2016. Gjatë këtij viti akademik, 2016-2017, situata ka ndryshuar si rezultat i implementimit



të kërkesave të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë". Në organogramën e vitit 2017 jepet hierarkia e organizimit strukturor të Albanian University. Në organogramë janë të përcaktuar organet kolegjiale vendimmarrëse, autoritetet drejtuese, komisionet e përhershme, vendi dhe roli i njësisë kryesore, njësisë bazë, njësitë administrative në ndihmë të aktiviteteve mësimore dhe shkencore të Institucionit dhe njësitë administrative nën varsinë e Bordit të Administrimit.

Programi i studimit "Master i shkencave në Inxhinieri Mekatronike" është i organizuar nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Departamentit të Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.

Fakulteti përbëhet nga tre departamente:

Departamenti i shkencave Ekonomike,
Departamenti i Arkitekturës,
Departamenti i Inxhinierive

Fakulteti drejtohet nga Dekani. Sipas Statutit, Dekani i fakultetit propozohet nga rektori dhe emërohet nga senati akademik mbi një proces konkurimi. Senati akademik përbëhet nga 19 anëtarë, nga të cilët 18 janë përfaqësues të personelit akademik dhe 1 është përfaqësues i studentëve. Në rregulloren e Albanian University përcaktohen raportet e përfaqësimit të personelit akademik nga secili fakultet. Anëtarët e senatit zgjidhen nga asambleja e personelit akademik.

Organ kolegjial drejtues i fakultetit është dekanati, i cili drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga dekani, Zv.dekani, Administratori i njësisë kryesore, dhe drejtuesit e departamenteve.

Organ tjetër kolegjial i fakultetit është asambleja e personelit akademik i fakultetit, e cila ka si funksione:

Propozon anëtarët e senatit akademik;
Propozon anëtarët nga personeli akademik që do të jenë pjesë në komisionet e përhershme;
Propozon programe të reja studimi ose kërkimi, hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësisish të tjera;
Shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanatit për veprimtarinë mësimore dhe shkencore;
Propozon planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikqyr realizimin e tij.

Departamenti. Në rregulloren e fakultetit citohet Departamenti si njësi bazë mësimore-shkencore që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Ai ka për detyrë të nxisë, të bashkërendojë dhe të administrojë veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore shkencore, duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Departamenti i Inxhinierive menaxhon 5 programe studimi te ciklit të pare dhe 4 programe studimi të ciklit të dytë në këto fusha inxhinjrike: Inxhinieri kompjuterike, Teknologji Informacioni, Inxhinieri elektronike, Inxhinieri Mekatronike dhe Inxhinieri Elektrike. Nga pikëpamja e shtrirjes, departamenti mbulon një diapazon të gjerë të fushave kërkimore apo të disiplinave mësimore.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara gjatë vizitës në institucion, datat 8-9 Maj 2017, figuron që numri i stafit efektiv është 23 (ref. tabela 1 dhe 2 e aneksit). Nga shqyrtimi i të dhënave, konstatohet se:

Në listë, tabela 2, figurojnë si staf efektiv me kohë të plotë, persona që e kanë kaluar moshën e pensionit (4 persona).

Në listë, tabela 2, figuron një person, i cili tashmë është larguar nga Albanian University (deklaruar nga drejtuesi i departamentit gjatë vizitës)

Ka një mospërputhje të numrit të personelit akademik efektiv me gradën doktor të departamentit të Inxhinierive të deklaruar në tabelën 2 dhe në tabelën 3.

Në listat e tabelës 2 figurojnë 2 persona si personeli akademik efektiv i dy departamenteve (Setki Mulla dhe Klodian Gumeni).

Aktualisht numri i personelit akademik efektiv me kohë të plotë është 22, nga të cilët 4 prej tyre kanë tejkaluar moshën e pensionit dhe mund të angazhohen në punë me kontrata njëvjeçare. Nga këta të katërt 1 person mban titullin “Profesor”, 1 mban gradën “Doktor” dhe 2 janë MSc. Pavarësisht këtyre pasaktësive, departamenti i plotëson kriteret minimale të përcaktuar në standardet shtetërore.

Në vitin akademik 2015-2016 janë deklaruar 19 personel akademik efektiv, nga të cilët 1 ishte Prof.Asoc., dhe 2 Dr. (reference Raporti i vleresimit të brendshëm për Programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronikë”).

Nëse krahasojmë listen emrore të stafit akademik efektiv të departamentit të Inxhinierive për vitet akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, konstatohet që 43% e stafit (10 persona nga 23 gjithsej) është i ri. (reference deklaratimet nga institucioni i listave emrore të stafit akademik të departamentit). Kjo spjegon edhe rritjen e numrit të personelit akademik me tituj dhe grada shkencore.

Në statutin e Universitetit, rregulloren e AU dhe në rregulloren e fakultetit shprehet mjaft qartë përgjegjësitë e departamenteve dhe të stafit të tyre për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Edhe në takimet e realizuara me drejtuesin e departamentit të Inxhinierive dhe me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënje në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri mekatronike”, u vu re përkushtimi i tyre dhe shkalla e lartë e përgjegjshmërisë për të përmirësuar kurrikulën dhe procesin e mësimdhënjes. Përgjegjësi i departamentit bënte përpjekje për të krijuar lidhje e bashkëpunime dy palëshe me Universitete italiane.

Departamenti ishte i përfshirë në procesin e rekrutimit. Ai përcakton vendet vakante dhe kriteret për rekrutimin e personelit akademik. Nga shqyrtimi i një praktike të procesit të rekrutimit për departamentin e inxhinierive në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, u konstatua se departamenti kishte përcaktuar vendet vakant si dhe kriteret për rekrutimin e pedagogëve, të cilat ishin të lidhura vetëm me shkallën e kualifikimit. Në kritere nuk përcaktohej fusha teknike e arsimimit të kandidatit. Në trupën e komisionit përzgjedhës të kandidaturave nga departamenti merre pjesë vetëm përgjegjësi i departamentit, i cili ishte me formim bazë matematikë. (reference: procedura e rekrutimit, dokument i paraqitur nga institucioni).

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij; Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete; Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente; Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	Kriteri 1. Mbështetur në Organogramën e Albanian University, Statutit dhe Rregullores së AU, të cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin 80/2015, gjykojmë se organizimi i Albanian University ndihmon në përmbushjen e misionit të Institucionit. Kriteri 2. Institucioni përbëhet nga 3 Fakultete Kriteri 3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga 3 departamente. Fakulteti i Shkencave Mjeksore përbëhet nga 3 departamente dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga 4 departamente.

<p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Kriteri 4. Njësitë bazë të punës mësimore shkencore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike janë:</p> <p>a) Departamenti i Inxhinierive b) Departamenti i Arkitekturës c) Departamenti i Shkencave Ekonomik</p> <p>Seicili prej departamenteve e ka të mirëpërcaktuar fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p>Kriteri 5. Departamenti ka mbi 7 punonjës akademik efektiv nga të cilët mbi 3 janë me tituj dhe grada shkencore. Ky kriter plotësohet.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Kriteri 1. Përgjegjësitë e njësive bazë dhe të stafit të tyre janë të përcaktuara qartë në rregulloren e Fakultetit. Këto njësi janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë e tyre në veçanti për sa i përket realizimit dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Njësitë bazë dhe kryesore bashkërendojnë punën në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Institucioni ka ngritur të gjitha strukturat në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi me qëllim realizimin dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. Njësitë bazë dhe njësia kryesore plotësojnë kriteret për të funksionuar si të tilla. Ato bashkërendojnë punën e tyre për të realizuar misionin e objektivat e universitetit. Njësitë bazë marrin pjesë në rekrutimin e stafit akademik efektiv. Përgjegjësi i departamentit dhe personeli akademik i departamentit të inxhinierive ishin të përgjegjshëm për rrëndësinë e realizimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit dhe roli i tyre në këtë process.</p> <p><i>Rekomandim:</i> Grupi i vlerësimit rekomandon që në procesin e rekrutimit të stafit akademik, të rritet numri i përfaqësimit nga departamenti, duke vendosur në komisionin e përzgjedhjes njerëz me njohje më të thellë të fushës teknike përkatëse.</p> <p>Standardet për organizimin strukturor të njësive kryesore dhe atyre bazë plotësohen.</p>	

Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Personeli akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë, efektive, si edhe personeli akademik me kohë të pjesëshme, me kontratë. Marrëdhënia e punës midis të punësuarve dhe Albanian University rregullohet nga kontrata e punës. Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektiv dhe me kontratë, administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse për dosjet e të punësuarve. Pëdagogët efektiv të rekrutuar për herë të parë, kanë një kontratë një vjeçare për vitin e parë dhe me pas vendoset kontratë pa limit. Pëdagogët që vijnë nga universitete të

tjera kanë kontrata semestrare të cilat firmosen për cdo semester sipas angazhimit akademik të tyre. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se dosjet e personelit akademik te brendshëm ishin të plota. Personeli akademik i jashtëm, i aktivizuar për këtë program studimi rezulton kryesisht nga UPT. AU ka një marrëveshje institucionale me UPT, por lejet nga departamentet për personelin përkatës akademik nga UPT, mungonin në dosjet e tyre.

Gjatë vizitës u evidentua se për vlerësimin e personelit ndiqen procedura ligjore dhe transparente. Vlerësimi nga studenti bëhet dy herë në vit nëpërmjet pyetësoreve.

Departamenti i Inxhinierive bën në fillim të vitit akademik planifikimin për personel akademik si dhe kërkesën angazhimit të tij. Takimi me stafin akademik u zhvillua në datë 8.05.2017 ku ishin të pranishëm gjithsej 8 pedagogë nga të cilët 5 ishin PAE dhe 3 ishin PAK. (Takimi me stafin e akademik u zhvillua i përbashkët për dy programet e studimit Msc. Inxhinieri Mekatronikë dhe MSc. Inxhinieri Kompjuterike)

Nga RVB si dhe nga dokumentacioni shtesë marrë gjatë vizitës, GVJ konstaton se në programin Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike gjatë vitit akademik 2016-2017, viti i dytë i aktivizimit të tij, janë gjithsej 11 pedagogë në total të angazhuar, 6 prej tyre janë me kohë të plotë dhe 5 janë me kohë të pjesshme, një prej pedagogëve Dr.Klodian Dhoska, ka qënë i brendshëm semestrin e parë deri në datën 4 prill 2017. I gjithë stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi është të paktën me gradën shkencore Doktor. Ngarkesa e stafit në këtë program studimi është gjithsej 1524.8 orë mësimore, nga të cilat 387.2 orë realizohen nga stafi akademik me kontratë dhe 1137.6 nga stafi efektiv. Ngarkesa që mban stafi efektiv përbën 74.6% të ngarkesës totale që realizohet në këtë program studimi. Gjatë vitit akademik 2015-2016, viti i parë i aktivizimit të këtij programi studimi, ngarkesa totale e realizuar ishte 995 orë, nga të cila vetëm 180 orë (pra 18.1%) janë realizuar nga stafi efektiv, ndërsa numri total i pedagogëve të angazhuar ishte 6, nga të cilët vetëm 1 ishte personel akademik efektiv. Nga krahasimi i këtyre shifrave, duket që ka një përmirësim përsa i përket plotësimin të disa kriterëve sasiore të standardeve shtetërore. Nga shqyrtimi i ndarjes së ngarkesës konstatohet se ka personel akademik efektiv që mbajnë ngarkesën 3-4 disiplina (15-20 ECTS) në këtë program studimi, përpos ngarkesave të tjera mësimore që mbartin në departament. Ngarkesa e madhe e personelit akademik, të përfshirë në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike”, konstatohet edhe nga pasqyra e shpërndarjes totale të ngarkesës në të gjitha programet e studimit të departamentit.

Ngarkesa totale e personelit akademik efektiv të përfshirë në MSc Inxhinieri Mekatronike:

Emër Mbiemër	PAE/PAK	Numri i Disiplin.	Nr.dis. Bch./MSc	Ngarkesa totale në orë	Ngarkesa javore në orë	Shënime
Adisa Daberdini	PAE	11	6/5	781	26	Rekrutuar si PAE në vitin akademik 2016-2017
Klodian Dhoska	PAE	9	3/6	510.6	17	Rekrutuar si PAE në vitin akademik 2016-2017. Larguar në Prill 2017
Genta Rexha	PAE	8	1/7	470	15.6	Përgjegjëse departamenti
Lek Pepkolaj	PAE	6	4/2	596	20	
Klodian Gumeni	PAE	5	2/3	260.4	8.7	Në vitin akademik 2015-2016 ka qenë PAK
Renalda Kushe	PAK	3	3	223.2	-----	Sipas udhëzimit 20 norma është 150 orë

Ilir Shinko	PAK	2	2	164.4	-----	Sipas udhëzimit 20 norma është 150 orë
Desar Shahu	PAK	4	2/2	256	-----	Sipas udhëzimit 20 norma është 150 orë
Petraç Marango	PAK	3	2/1	465	-----	Sipas udhëzimit 20 norma është 150 orë

Në RVB deklarohet që shpërndarja e ngarkesës bëhet duke respektuar kriteret dhe normat e vendosura në Udhëzimin Nr.20 i MAS për Ngarkesën mësimore të stafit akademik. Duket qartë që një pjesë e madhe e stafit akademik (PAE dhe PAK) është i mbingarkuar jo vetëm me orë mësimore, por edhe me numër të madh disiplinash në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Kjo dukuri mbështetet edhe nga politikat e shpërblimit të stafit efektiv, duke nxitur kryerjen e një ngarkese sa më të madhe.

Një problem tjetër është lidhja e arsimimit bazë të personelit akademik me fushat e lëndëve ku janë përfshirë, në programet e studimit të departamentit. Po japim disa shembuj:

- Dr Adisa Daberdini, me gradën Doktor në Inxhinieri Fizike, master në Inxhinieri Fizike, dhe Bachelor në Inxhinieri Elektronike, jep lëndët “Algoritëm dhe programim i avancuar”, teori rrjetash, telekomunikacion me fibra optike, projektim sistemesh elektronike, komunikim numerik, etj.
- Dr. Klodian Gumeni me formim në Inxhinieri Mekanike dhe Doktoraturë në Inxhinieri mekanike, jep disiplinat: “Automatika e komandimit industrial”, “Teoria e sistemeve mekanike” dhe “Teoria e sistemeve dinamike”, fizikë teknike.
- Dr. Klodian Dhoska, me formim Inxhinieri Mekanike jep disiplinat “ Teknologji Mekanike”, pajisjet biomedikale, programim i orientuar nga objekti, pajisje ekzistuese, projektim sistemesh kontrolli, optoelektronika dhe pajisjet optike, kontrolli i sistemeve mekatronike, elektronikë e aplikuar në mekatronikë, fizikë teknike.
- Genta Rexha me formim bazë në inxhinieri aerospaciale, jep disiplinat: Menaxhim sistemesh informacioni, teknologjia e sistemeve të kontrollit, sisteme operative të avancuara, sensorë dhe instrumentim procesesh, kontrolli i sistemeve mekatronike, optoelektronika dhe pajisjet optike.

Rekomandim: GVJ rekomandon që të punohet për të ulur numrin e disiplinave që mbulon një pedagog dhe për të ngarkuar pedagogët me lëndë që janë pjesë e formimit karakterizues në programet e studimit që kanë përfunduar, ose janë kualifikuar më tej.

Në RVB deklarohet se Përgjegjës i programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike është Prof.Asoc.Dr. Agim Anxhaku, i cili është staf akademik me kontratë. Në RVB nuk ka të dhëna mbi këshillin (komitetin) shkencor të programit të studimit.

Rekomandojmë që të evidentohet ky komitet dhe koordinatori (apo përgjegjësi) i programit të studimit të jetë një anëtar nga personeli akademik efektiv.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit. Departamenti nuk kishte organizim me seksione. Megjithatë në departament ishte një grup pedagogësh, me formim inxhinierik dhe gradë shkencore Dr (4), që mbanin dhe menaxhonin ngarkesën për formimin karakterizues në programin e studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike.

Në aneksi 1 jepen:

Tabela 1. Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK) në Departamentin e Inxhinierive. Të dhënat i referohen listës së përditësuar që na u vu në dispozicion gjatë vizitës në departament.

Tabela 2. Lista emërore e Pedagogëve Efektiv dhe me Kontratë të Departamentit të Inxhinierive, departamentit të arkitekturës, departamentit të shkencave ekonomike, si dhe lista e stafit të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike”

Tabela 3 Të dhënat për këshillin shkencor të programit të studimit

Tabela 4 Të dhënat e stafit akademik sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Tabela 5 Të dhënat e personelit akademik efektiv dhe atij administrativ sipas grup-moshave

Tabela 5-1 Të dhënat e personelit akademik efektiv dhe atij administrativ sipas grup-moshave, të përfshirë në programin e studimit MSC Inxhinieri mekatronike

Tabela 6 Të dhëna sipas moshës së personelit me kontratë të departamentit të inxhinierive

Tabela 6-1 Të dhënat e personelit akademik me kontratë sipas grup-moshave, të përfshirë në programin e studimit MSC Inxhinieri mekatronike

Tabela 12. Lista emërore e pedagogëve efektiv dhe me kontratë që mbështesin disiplinat e planit mësimor të programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronikë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Kriteri 1. Personeli akademik, ndihmës mësimor - shkencor dhe administrativ kishin kompetencat e nevojshme dhe ishin të angazhuar në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Stafi akademik i përfshirë në mësimdhënje në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike” plotësonte kërkesat për realizimin sa më cilësor të tyre në përputhje me kuadrin ligjor mbi arsimin e lartë në Shqipëri.</p> <p>Kriteri 2. Në strategjinë e zhvillimit të institucionit, shprehet edhe objektivi për rritjen profesionale të stafit akademik. Stafi ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme dhe angazhohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Kriteri 1: Nga takimet e bëra në Departamentin e Inxhinierisë evidentohet që personeli akademik luan rolin kryesor në hartimin e kurrikulës mësimore. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, procedura e rishikimit të programeve të studimit fillon në departament me përfshirjen e stafit akademik me tituj e grada dhe kalon nëpër hallkat e tjera deri në miratim në senatin akademik. Për këtë program studimi nuk ka patur ndonjë proces rishikimi.</p>

	<p>Kriteri 2. Punësimi i personelit të ri bëhet sipas kuadrit ligjor. Përsa i përket përcaktimit i ngarkesës mësimore, u konstatua një ngarkesë e madhe orësh mësimore për pedagogët e brendshëm dhe një pjesë e pedagogëve me kontratë.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Kriteri 1: AU ndjek procedura ligjore të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren e tij. Kërkesat për staf akademik me kohë të plotë janë të përputhura me strategjinë e zhvillimit institucional të institucionit (2017-2022). Procedura janë transparente; AU njoftim për vende të lira pune në media dhe kryen intervista me personat e zgjedhur.</p> <p>Kriteri 2: Në programin e studimit MSc Inxhinieri Mekatronike, për vitin akademik 2016-2017, ngarkesa mësimore mbulohet në masën rreth 75% nga personeli akademik efektiv, ndërsa sipas RVB për vitin e akademik 2015-2016 ishte 48 %.</p> <p>Duke patur parasysh ngarkesën e madhe që mban stafi akademik efektiv, është e nevojshme që në vijim të punohet për të rritur numrin e stafit akademik të brendshëm dhe të kualifikuar në fushën e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3, 4: AU ka një bazë të dhënash me informacionin e nevojshëm për stafin. Në zyrën e Burimeve Njerëzore u verifikua informacioni në lidhje me procedurën e rekrutimit të personelit akademik dhe u verifikuan përmbajtjet e dosjeve të personelit akademik. Kontratat e përgatitura për personelin akademik bëhen në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me Kodin e Punës. Afati i kontratës është 1 vjeçarë për pedagogët e rinj që fillojnë për herë të parë në këtë universitet dhe më pas kontrata rinovohet mbi bazën e performancës së tyre dhe bëhet pa afat. Departamenti i Burimeve Njerëzore ndjek të gjithë politikat në përputhje me kërkesat që shfaq departamenti. Kontratat në lidhje me punonjësit me kohë të pjesshme janë semetrale dhe në varësi të lëndës që ofrohet.</p> <p>U konstatua se kishte një marrëveshje me UPT shoqëruar me një listë emërore, por në dosjet e stafit akademik me kohë të pjesëshme mungonte leja nga departamenti.</p> <p>U bënë verifikimet me listen e stafit akademik të angazhuar për programin Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, u kërkua shqyrtimi i</p>

	<p>dosjeve të stafit të përzgjedhur në mënyrë rastësore si më poshtë vijon: Agim Anxhaku, Petraq Maranga, Klodian Gumeni, Genta Rexha.</p> <p>Departamenti ndjek procedura transparente për vlerësimin e personelit, duke realizuar vlerësime periodike si nga studentët ashtu edhe nga përgjegjësi i departamentit.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Kriteri 1: Përgjegjësi i programit të studimit është Prof.asoc.Dr.Agim Anxhaku, i cili është personel akademik me kontratë.</p> <p><i>Rekomandohet që përgjegjës i programit të studimit të jetë personel akademik efektiv.</i></p> <p>Kriteri 2 Titullarët e lëndëve kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p><i>Rekomandohet që si titullarë lënde të mos figurojnë emra që nuk janë më pjesë e stafit akademik të përfshirë në mësimdhënje.</i></p> <p>Kriteri 3 N/A</p> <p>Kriteri 4 Drejtuesit e AU, Rektori, Zv/rektoret, Dekani i Fakultetit të Shkencave të Aplikauara dhe Ekonomike dhe përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë, që janë përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, janë të punësuar me kohë të plotë në institucion. Përgjegjësi i programit të studimit nuk është i punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Kriteri 5 Departamenti i Inxhinierisë cakton personel akademik të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara</p>	<p>Kriteri 1 Departamenti i Inxhinierisë cakton një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën për cdo student. Gjatë vizitës u konstatua se studentët e vitit të dytë kishin tashmë të caktuar udhëheqësin e temës. Studentet i nënshtrohen tre kontrolle në departament për ecurinë e punimit të diplomës.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësit e diplomave kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe nuk u evidentuan raste kur udhëheqësi mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht.</p>

<p>në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Kriteri 3 Deri më tani nuk ka patur të diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Fusha studimore-kërkimore në të cilën udhëheqësit janë të specializuar është në fushat e inxhinierisë elektronike, mekatronike, mekanike dhe elektrike, gjithashtu rezulton se udhëheqësit kanë eksperiencë në fushat e tyre të kualifikimit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Albanian University angazhon një staf ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve praktike laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratoreve dhe ambientet si sallë interneti, salla e bibliotekës etj.</p> <p>Burimet njerëzore të angazhuar në programin e studimit MSc Inxhinieri Mekatronike përdoren në përputhje me objektivat e programit të studimit.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimit Msc Inxhinieri Mekatronike vlerësohet me orë mësimore. Orët faktike në auditor konvertohen në orë mësimore sipas udhëzimit të MAS Nr.20</p> <p>Ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kontratë është në disa raste më shumë se dyfishi i normës mësimore të përcaktuar në Udhëzim. AU nuk kishte ndonjë udhëzim të brendshëm në lidhje me kufirin maksimal të ngarkesës mësimore që mund të realizojë një pedagog.</p> <p>Në disa raste, numri i disiplinave që mbulon një pedagog në këtë program studimi është i lartë (3-4)</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Albania University ka zyrën e Burimeve Njerëzore, ku mbahen të gjitha të dhënat për personelin. Këto të dhëna kanë të bëjnë me personelin akademik dhe ndihmës mësimor të angazhuar në programin e studimit sipas lëndëve për çdo semestër akademik.</p> <p>Rekrutimet e personelit bazohen në përcaktimin dhe publikimin e kritereve dhe procedurave të punësimit.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Albania University ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe për angazhimin e personelit akademik me kontratë. Departamenti i Inxhinierive angazhon një personel akademik efektiv dhe me kontrate. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë mbulon rreth 75% të ngarkesës mësimore totale për realizimin e programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike. Mësimdhënia i nënshtrohet një proces vlerësimi periodik.

GVJ konstaton që personeli akademik me kohë të plotë ka një ngarkesë shumë të madhe në orë mësimore, kjo ngarkesë konsiderohen shqetësuese edhe prej faktit se këta pedagogë angazhohen edhe në programe të tjera studimi që ofrohen nga departamenti. Gjithashtu, vihet re se edhe pse stafi është i kualifikuar me gradën Doktor, fusha e tyre e kualifikimit nuk përputhet shumë mirë me fushën e disiplinave që ata mbulojnë në këtë program studimi. Koordinator i programit të studimit nuk është pjesë e personelit akademik efektiv.

Në këtë kuadër, GVJ rekomandon:

- 1. Të evidentohet komiteti shkencor i programit të studimit dhe koordinatori i këtij programi të jetë një anëtar nga personeli akademik efektiv.**
- 2. Të punohet për të ulur numrin e disiplinave që mbulon një pedagog dhe për të ngarkuar pedagogët me lëndë që janë pjesë e formimit karakterizues në programet e studimit që kanë përfunduar, ose janë kualifikuar më tej.**
- 3. Pavarësisht marrëveshjes institucionale, të lidhur ndërmjet UPT dhe AU, personeli akademik me kontratë, duhet të depozitohet edhe lejen nga departamenti për angazhimin në mësimdhënie pranë AU.**

Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkimore

Programi i Studimit Master në Inxhinieri Mekatronike ofrohet në një ndërtesë në rrugën e Kavajës, Tiranë. Ambjentet janë të përshtatshme për leksione, praktika dhe laboratorë. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë si salla e internetit ndodhen në të njëjtën ndërtesë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Biblioteka është e pajisur me të gjithë aksesoret dhe lehtësirat për një studim dhe marrje informacioni. Nëpërmjet bibliotekën online QUESTIA, pedagogët dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë pa limit shumë tituj të publikimeve shkencore dhe didaktike. Salla është e pajisur me tavolina studimi dhe kompjutera. Interneti është në dispozicion gjatë orëve të studimit por edhe në punën kërkimore shkencore të pedagogëve.



Oftohet literatura bazë dhe ndihmëse. Departamenti i Inxhinierive zotëron 9 laboratorë për zhvillimin e laboratoreve të programeve të studimit që ofron, ku përfshihet edhe në MSc. Inxhinierike Mekatronike.

GVJ nuk konstaton ndryshime në të dhënat për infrastrukturën të deklaruar në RVB e Programit të studimit MSc Inxhinieri Mekatronike.

Nga një shqyrtim i të dhënave të deklaruara nga Institucioni në lidhje me stafin akademik efektiv dhe infrastruktura e vënë në dispozicion të tij, GVJ konstaton se:

1. Fakulteti ka 3 departamente dhe vetëm 2 zyra për to.
2. Në godinën e Rrugës së Kavajës, në RVB deklarohet se janë 3 zyra me një sipërfaqe totale 71 m² për stafin akademik të departamenteve të Arkitekturës dhe Inxhinjerive, me një numër total të stafit akademik efektiv, sipas listës emrore, të deklaruar është 45. Nëse heqim numrin e drejtuesve të departamenteve (2) dhe persëritjen në dy raste të emrave në dy departamente, marrim numrin stafit efektiv të akomoduar në ambientet e vëna në dispozicion rreth 41. Sipërfaqja e zyrës/personel akademik efektiv është 1.73 m²/ped.
3. Numri i njeve higjeno-sanitare në dispozicion të personelit akademik efektiv është vetëm 1 për 68 pedagogë, pa marrë në konsideratë stafin akademik me kontratë.

Rekomandohet: AU të investojë për përmirësimin e kushteve infrastrukturore për stafin.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhënat infrastrukturore, sipas deklarimeve në RVB e programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike, jepen në Aneksin 2, si më poshtë

Në Aneksin 2, Tabela 8 jepen Mjediset e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në dispozicion të programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike

Në Aneksin 2, Tabela 9, jepen të dhëna për mjediset e vëna në dispozicion të stafit në nivel Fakulteti

Në Aneksin 2, Tabela 10, jepen të dhëna për mjediset e vëna në dispozicion të stafit në nivel Universiteti

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të</p>	<p>Albanian University ka disa godina në dispozicion. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Inxhinierisë që ofrojnë programin e studimit Master i Shkencave Inxhinieri Mekatronike e kanë vendodhjen tek rruga e Kavajës.</p> <p>Mjediset janë në dispozicion të Albania University për më shumë se 6 vjet;</p> <p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike zhvillohet në një godinë.</p> <p>Gjatë vizitës dy ditore u konstatua se Albania</p>

<p>parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>University ka siguruar ambjettet e duhura, zotëron një infrastrukturë të vlefshme për të siguruar një mësimdhënie cilësore për këtë program. Sallat e leksioneve, seminareve janë të pajisura me aksesoret e nevojshëm për të zhvilluar mësimin. Laboratorët janë të pajisur me mjetet dhe pajisjet bazë për temat që trajtohen.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Për zbatimin e programit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, në godinën e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është vënë në dispozicion edhe një bibliotekë e cila ka kapacitetin e mjaftueshëm për të studiuar studentët. Biblioteka dhe salla e internetit janë në të njëjtin vend. Biblioteka është e pajisur me libra shkollore në gjuhën shqipe dhe anglisht. Një pjesë e tyre ishte në formën e dispencave në gjuhën shqipe, të hartuar nga titullarët e lëndëve.</p> <p>Fondi i librave në fushën e mekatronikës ishte pasuruar disi, por megjithatë literatura në këtë drejtimin mbetet e kufizuar. Duhet bërë përpjekje për pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës me literaturë më bashkëkohore.</p> <p>Biblioteka ka një skedar regjistrimi për çdo student.</p> <p>Biblioteka është e hapur për një periudhë kohore 8.00-16.00 sipas nevojave të studenteve dhe është e pajisur me mjete didaktike dhe akses në internet.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë pamë që përdorej libraria elektronike Questia.</p> <p>Nga bisedat e bëra mendojmë që përgjegjësit e këtij programi studimi bëjnë përpjekje për pasurimin e literaturës. Staf i drejtues i AU duhet të shtoj buxhetin për blerje librash fundamental dhe periodikë në fushën e inxhinierisë mekatronike.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me</p>	<p>Albania University ka ambiente të cilat ofrojnë një hapësirë të mjaftueshme për studim. Programi i studimit Msc. Inxhinieri Mekatronike zhvillohet në godinën nr.1 përshkrimi i të cilës është bërë qartë më sipër në përshkrimin e infrastrukturës. Godina është e pajisur me auditorë që kanë një kapacitet mbajtës 75 studentë për salla leksioni, salla seminari me kapacitet 30-50 studentë. Në godinë janë të vendosur laboratorë dhe sallë interneti. Çdo auditor dhe sallë leksioni është e pajisur me tabela të mjaftueshme për pedagogun. Sallat e</p>

<p>qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>seminareve janë të vogla që mundësojnë zhvillimin e seminareve në grupe të vogla.</p> <p>Për zhvillimin e MSc në Inxhinieri Mekatronike laboratorët e vënë në dispozicion janë të mjaftueshem për zhvillimin e moduleve mësimore. Zakonisht janë me 6 – 8 tavolina pune ku akomodohen lehtësisht 12 studentë. Në shërbim të programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike vihen në dispozicion 6 laboratorë si: Laboratori i Informatikës, Elektronikës, Baza Elektronikë dhe Makinat Elektrike, Mekatronikës dhe Automatikës; Matjeve elektrike dhe elektronike, elektronikës analog-dixhital. Laboratorët janë të pajisur me software simulimi dhe projektimi (MATLAB etj) si edhe me materiale e komponente të elektronikës dhe mekatronikës të cilat vihen në dispozicion të studenteve.</p> <p>Nga shqyrtimi i listës së pajisjeve të laboratorëve konstatohet se laboratorët kanë aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e laboratorëve të nevojshëm për këtë program studimi.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe Departamenti i Inxhinierive zotëron mjedise të mjaftueshme për të zhvilluar programet e studimit që mbulon ky departament. Ambientet ku ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike janë të bollshme dhe të pajisura me komponentet e duhur për të siguruar një mësimdhënie cilësore. Në godinë është e vendosur biblioteka e Fakultetit e cila siguron literaturë modeste për këtë program studimi. Departamenti i Inxhinierisë vë në dispozicion të programit të studimit MSc Inxhinieri Mekatronike 6 laboratorë për zhvillimin e laboratoreve për grup-disiplinat e këtij programi studimi.

GVJ konstaton se mjediset e punës në dispozicion të stafit akademik efektiv, 1.73 m²/pedagog, janë të pamjaftueshme për zhvillimin normal të aktivitetit të pedagogut.

Rekomandim:

- 1. Përmirësim i kushteve të punës për stafin akademik efektiv të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.**
- 2. Në mbështetje të rekomandimit të dhënë në RVB, AU duhet të synojë rritjen e llojshmërisë së periodikëve për të plotësuar më mirë fushat e aktivitetit kërkimor në Inxhinieri Mekatronike**

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Sipas RVB, burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare. Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në nivel universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor, të hartuar dhe certifikuar nga eksperte të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet

shoqerore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj. Kostot operative vjetore ndryshojnë nga njeri program studimi tek tjetri, për shkak të vecorive që ka secili prej tyre. Pasqyra financiare e dhënë në raport i referohet vitit akademik 2015-2016. Aty bie në sy që shpenzimet për veprimtari shkencore të departamentit për këtë program studimi janë vetëm 20,000 lek. Mbështetur në deklaratimet e bëra në takimet në departament, investimet e realizuara për vitin 2016 ishin fokusuar kryesisht në pasurimin dhe mirëmbajtje të laboratoreve për rreth 1,066,460 lek. (tabela e investimeve, dokument i përditësuar, i hedhur në sistem). Gjithashtu është mbështetur pjesëmarrja në konferenca shkencore e stafit akademik efektiv si dhe konferenca studentore. Për vitin 2017 është planifikuar një rritje e shpenzimeve në zërat e kërkimit me rreth 8.5%, ku peshën kryesore e mban investimi për laboratorët me rreth 47.7% të investimit total, ndërsa zërat konferenca dhe udhëtime zen rreth 39%. Një zë i veçantë është fondi i ekselencës, i cili përbën 8.3% të investimit total.

Tabela 5.1 Mbi realizimin e veprimtarise shkencore per vitin 2016 dhe Plani per vitin 2017

Nr	Emertimi veprimtarive	njesi	VITI 2016	VITI 2017
1	Konferenca Studentore,	lekë	86,000	90,000
2	Konferenca Nderkombetare,	lekë	476,000	500,000
3	Udhetime Jashte shtetit	lekë	400,000	350,000
4	Për veprimtari te tjera shkencore	lekë	42,000	120,000
5	Pajisje Laboraror	lekë	927,360	1,000,000
6	Mirëmbajtje Laborator	lekë	139,100	150,000
7	Fondi ekselences	lekë	150,000	200,000
	Totali	lekë	2,220,460	2,410,000

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Sipas RVB , AU bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e cdo viti kalendarik.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat, duke iu referuar bilancit.</p> <p>Nga raporti dhe vizitat e bërë në institucion kemi konstatuar që nuk ka grante të huaja, sponsorizimi, shërbime trainuese dhe kontrata shërbimesh të lidhura për të mbështetur këtë program studimi.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme</p>	<p>Institucioni harton raportin e bilancit te te gjithe shoqerise cdo vit, ne te cilin parashikohen te dhena te hollësishme financiare per te ardhurat.</p> <p>Sipas deklarimeve të RVB, si dhe dokumentave të marra në institucion, për</p>

<p>për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>vitin akademik 2015-2016 bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve referuar programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike është negativ. Pavarësisht kësaj, AU në total ka nje stabilitet ekonomik për vazhdimësinë e aktivitetit akademik dhe shkencor te departamentit të inxhinjerive.</p> <p>Theksojme se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj të perftuar nga kontratat e shërbimeve.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Financimi dhe te ardhurat per Departamentin e Inxhinierise, jane pjese e informacionit dhe te dhenave te Albanian University. Për vitin akademik 2015-2016, bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve referuar programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike është negativ. Pavarësisht kësaj, AU në total ka nje stabilitet ekonomik për vazhdimësinë e aktivitetit akademik dhe shkencor te departamentit të inxhinjerive.</p> <p><i>Rekomandohet që departamenti i inxhinjerive, për vetë natyrën aplikative të fushës së veprimtarisë së saj, duhet të bëjë përpjekje që të sigurojë të ardhura të tjera nga projektet dhe shërbimet për të tretë.</i></p>	

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Në Albanian University sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë sigurohet nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është në varësi të Rektorit të Universitetit dhe ka detyrimin e paraqitjes vjetore të raportit. Në këtë raport përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si edhe rekomandon masa që duhet të merren në lidhje me përmirësimin cilësor të mësimdhënies. Sistemi i brendshëm i cilesisë funksion në cdo departament. Kjo zyrë ndërmer hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat më tej shpërndahen në departamentin e inxhinierisë dhe pas plotësimit të tyre prej pedagogëve dhe studentëve . Nga modelet e pyetësorëve del se përgjithësisht tendenca ka qenë për të marrë mendime për çdo lëndë të programit. Gjatë intervistës me studentët, ata u shprehen të kënaqur me faktin që opinionet e tyre të marra nëpërmjet pyetësorëve ishin marrë në konsideratë .

Në tabelën 7 jepen të dhënat në lidhje me Njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	<p>Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përdor metodologji vlerësimi për cilesine e mësimdhënies dhe instrumenta mates, nga të cilat mund të përmenden: raportet semestrale dhe vjetore; tërheqja e mendimit të studenteve, nëpërmjet pyetsorëve të vlerësimit në fund të cdo moduli; analiza e rezultateve në fund të</p>



<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; • Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; • Pyetje konceptuale; • Intervista; • Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); • Dëgjime në auditor; • Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; • Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; • Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; • Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; • Etj. 	<p>edo provimi.</p> <p>Matja e cilesisë për programin Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike bëhet nga shefi i departamentit të inxhinierisë përmes kontrollit në bazë të një plan pune të vendosur në fillim semestri tek stafi PAK dhe PAE.</p> <p>AU ka institucionalizuar praktikën e sigurimit të cilësisë së brendshme duke ngritur NJSBC. Kjo njësi, ndjek procesin e vlerësimit të cilësisë, duke matur ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi. Në këtë proces, NJSBC përdor metodologji të caktuar, me instrumente matëse dhe vlerësuese. Vlerësimi bëhet nëpërmjet instrumentave që përdor NJSBC dhe nga shefi i departamentit nepermjet kontroleve dhe analizave. NJSBC e përfshin këtë informacion në raporte semestrale dhe vjetore, ku përfshihen edhe të dhënat e % e kalueshmërisë dhe notat mesatare</p> <p>AU përdor praktika, procedura dhe instrumente të vlerësimi, monitorimi e evidentimi të cilësisë, si: pyetësorët, intervistat, rezultatet e detyrave, testeve paraprake, provimeve, vëzhgime në praktikë, kontrole te pedagogët.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>ZSCB në bashkëpunim me Fakultetin dhe me Departamentin e Inxhinierisë janë përgjegjës për përgatitjen e raporteve për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Në raportin vjetor të AU, publikon rezultatet e pritshme dhe rezultatet që synon të arrijë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike nuk publikon prezantime në faqe interneti, video e audio etj për vlerësimin e brendshëm.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të</p>	

studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesen e ZSCB konstatohet se hartohen raporte vjetore në lidhje me ecurinë e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike. Raporti është i bazuar në të dhënat e mbledhura përmes pyetsorëve nga studentët, duke parë rezultatet e studentëve në provime, nga kontrollet periodike të organizuar nga departamenti i inxhinierisë . Raporti më pas i kalohet Rektorit të Universitetit dhe Senatit dhe ndërmerren masa për të plotësuar rekomandimet e shprehura në këto raporte.</p> <p>AU ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë bërë publike.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Albania University është në proces akreditimi institucional për të gjithë universitetin.</p> <p>Albania University ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. AU ka përgatitur një sërë instrumentesh të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë.</p> <p>AU ka përcaktuar politikën e sigurimit të cilësisë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe të standardeve të programeve të studimit.</p> <p>AU kryen shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programeve të studimit.</p> <p>AU ka përgatitur materiale dhe ka organizuar trajnime për informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit dhe të studentëve për sigurimin e cilësisë dhe rolin e tyre në këtë proces.</p> <p>AU ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë bërë publike.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Albania University garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve. AU ka ngritur Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë , e cila ka përgatitur një sërë instrumentesh të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë . Vlerësimi për procesin mësimor bëhet dy herë në vit para sesionit të provimeve. Vlerësimet pasqyrohen në raporte semestrale dhe në raportin vjetor. Në këto analiza përfshihen edhe të dhënat mbi kalueshmërinë dhe notënmesatare të</p>	

studentëve. AU është tashmë në proces akreditimi institucional nga QAA.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Misioni dhe objektivi i programit të studimit:

Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike” është liçensuar në vitin akademik 2011 – 2012 dhe ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2015-2016. Ky program studimi është liçensuar me kushtin që të vendoset një raport i balancuar midis fushave baze të formimit: mekanikes, elektronikës, elektroteknikes, informatikes. Institucioni nuk dha ndonjë informacion shtesë për plotësimin e këtij kushti.

Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike” synon t’u ofrojë studentëve njohuri të nevojshme për të fituar kompetenca të avancuara shkencore dhe profesionale në fushën e Mekatronikës përmes metodave, instrumenteve dhe teknikave inovative. Përvetësimi i këtyre aftësive bëhet i mundur në sajë të thellimit të njohurive që studentët marrin në programet *Bachelor* në fushën e Inxhinierisë Mekatronike. Këto njohuri bazë thellohen më tej gjatë studimit në programet *Master i Shkencave* duke i zbatuar në planin metodologjik dhe aplikativ në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të përballuar problematikat e ndryshme të fushës së studimit, projektimit të avancuar, të planifikimit e të administrimit të sistemeve komplekse si dhe për të dhënë kontributin përkatës në zhvillimin shkencor dhe teknologjik të këtij sektori.

Formimi teoriko-praktik në kuadër të “Masterit të Shkencave në Inxhinieri Mekatronike” bën të mundur integrimin e shpejtë të të diplomuarve në tregun e punës.

Në RVB deklorohet se të diplomuarit në kuadër të këtij programi studimi do të marrin njohuritë teoriko-praktike të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre:

- a) Aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në institucione e firma të ndryshme ku ka sisteme mekatronike të aplikuara;
- b) Aftësinë për të konceptuar dhe realizuar sisteme mekatronike të thjeshta;
- c) Aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit;
- d) Aftësinë për të ndërhyrë në drejtim të mirëmbajtjes së sistemeve mekatronike të aplikuara në sektorin komunal, transport apo pajisjet elektroshtëpiake;
- e) Mbas një periudhe stazhi në profesion, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këtë fushë.

Shënim: objektivat formues për programin e studimit nuk i përgjigjen qëllimit të një programi studimi të nivelit Master i Shkencave. Ato afrohen më shumë me një Master Profesional. Megjithatë në disa disiplina karakterizuese, syllabuset janë të një niveli të lartë teorik, në përputhje me synimet dhe objektivat formuese që duhet të ketë një program studim Master i Shkencave, implementimi i tyre në praktikë, nga bashkëbisedimi me studentët dhe me stafin akademik bëhet duke i thjeshtësuar argumentet në aspektin aplikativ për t’i bërë më të kuptueshëm nga studentët. Kjo kushtëzohet edhe nga formimi bazë teorik i studentëve që kanë hyrë në këtë program studimi.

Programi i studimit është i organizuar në 120 ECTS, me kohë normale të përfundimit të tij 2 vite akademike. Viti akademik 2016-2017 është viti i dytë i implementimit të tij. Viti akademik është i organizuar në 2 semestra, 30 javë mësimore. Çdo semester përbëhet nga 15 javë mësimore. 1 ECTS = 25 orë mësimore, nga të cilat më shumë se 50% të orëve e përmban puna e pavarur e studentit. 1 orë mësimore llogaritet 60 minuta.

Plani mësimor është i organizuar në module dhe lëndë, seicila prej të cilave shprehet me kredite. Në RVB jepen grupimi i disipinave dhe moduleve sipas veprimtarive formuese që sigurojnë dhe raportet ndërmjet tyre:

PLANI MËSIMOR – Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike			
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Metoda numerike për zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale të zakonshëm dhe me derivate të pjesshme. Përafrimi i ekuacioneve diferenciale me derivate të pjesshme me diferenca të fundme	(5-5) 10	10
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Teknologjia e sistemeve të kontrollit. Kontrolli i sistemeve mekatronike	(5-5) 10	50
	Teknologji mekanike	4	
	Teoria e sistemeve mekanike. Teoria e sistemeve dinamike	(4-5) 9	
	Inteligjencia artificiale. Robotika	(4-4) 8	
	Sensorët dhe instrumentim procesesh (1-2)	(5-5) 10	
	Elektronika e fuqisë	5	
	Menaxhim projektsh	4	
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe ose integruese (C)	Automatika e komandimit industrial	6	10
	Kontrolli dixhital	4	
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Lëndë me zgjedhje (Gr.1)	4	8
	Lëndë me zgjedhje (Gr.2)	4	
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Algoritëm dhe programim i avancuar	6	12
	Praktika mësimore	6	
Teza e Diplomës (F)	Teza e diplomës	30	30

Disiplinat të formimit të përgjithshëm plotësojnë 10 ECTS ose 8.3 % të programit të përgjithshëm.
 Disiplina të formimit karakterizues plotësojnë 50 ECTS ose 41.7 % të programit formues.
 Disiplinat formuese të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese plotësojnë 10 ECTS ose 8.3 % të programit formues.
 Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët plotësojnë 8 ECTS ose 6.7 % të programit.
 Disiplinat e veprimtarisë formuese, për gjuhë, informatikë dhe praktika plotësojnë 12 ECTS ose 10 % të programit të formimit.
 Provimi i diplomës plotëson 30 ECTS ose 25 % të strukturës Master i Shkencave.

Koment: Lënda Menaxhim Projektsh nuk mund të jetë e formimit karakterizues, pasi nuk i përket asnjërës prej fushave bazë inxhinjerike të formimit të Inxhinierit Mekatronik. Ajo mund të klasifikohet si një disiplinë që jep njohuri formuese plotësuese, e veprimtarisë formuese E. Në këtë aspekt, disiplinat e formimit karakterizues do të përbënin 38.8% dhe ato të formimit plotësues dhe praktik do të përbënin 13.3%

Për çdo lëndë është bërë ndarja e krediteve sipas formave të mësimdhënjes : Leksion/ Seminare/ Ushtrime/ Laboratore/detyra. Këto shprehen në planin mësimor të detajuar, **por nuk jepen në syllabuset e lëndëve.**

Institucioni ka të përcaktuar mënyrën e konvertimit të krediteve në orë mësimore në auditor dhe orë pune e pavarur për të gjitha format e studimit, si më poshtë vijon:

Për Leksionet	9-11 orë në auditor dhe 14-16 orë pune e pavarur e studentit
Për seminarët/ushtrimet	13-16 orë në auditor dhe 9-12 orë pune e pavarur e studentit
Për Laboratorët	15-16 orë në auditor dhe 9-10 orë pune e pavarur e studentit
Për praktikën profesionale	0 orë në auditor dhe 25 orë pune e pavarur e studentit
Provimi përfundimtar	3 orë në auditor dhe 22 orë pune e pavarur e studentit

Në përcaktimin e orëve mësimore për forma të ndryshme të studimit (Leksion, Ushtrime/Seminare, Laboratore) për lëndët e këtij plani mësimor, pavarësisht natyrës të njejtë, inxhinjerike të tyre janë përdorur koeficientë të ndryshëm brenda diapazonit të luhatjes të përcaktuar nga institucioni. Kështu për leksionet kemi një luhatje nga 9.2 në 10.5 dhe për ushtrimet nga 11.5 në 16. Këto luhatje brenda të njejtit plan mësimor sjellin një mbivlerësim të një disipline në raport me tjetrën dhe fshehin ngarkesën reale mësimore që ka një lëndë. Konstatohet që për detyra dhe projekte nuk janë parashikuar mënyra e konvertimit të krediteve në ore në auditor.

Rekomandim. Brenda të njejtit plan mësimor konvertimi i kreditit në orë në auditor për të gjitha format e studimit rekomandojmë të jetë i njejtë. Të përcaktohet mënyra e konvertimit të krediteve të ushtrimeve/projekteve në orë në auditor. Praktika profesionale të konsiderohet orë në auditor për studentin, pasi ajo kryhet nën mbikqyrjen e pedagogut apo të një specialisti të kompanisë ku kryhet praktika.

Në RVB dhe në takimet e kryera është deklaruar që nuk ka ndryshime në planin mësimor, krahasuar me atë të licensuar. Madje nuk janë reflektuar as rekomandimet e dhëna në urdhërin e liçensimit.

Në tabelën 11 të aneksit 3 jepet plani mësimor i liçensuar. Në formë të përmbledhur ngarkesa në orë mësimore për çdo lëndë, të grupuar sipas semestrave jepen në tabelën e mëposhtme

Përmbajtja e programit:

Viti i parë

Semestri I (15 javë)

<u>Nr.</u>	<u>Lënda</u>	<u>ECTS</u>	<u>Orë në auditor</u>	<u>L</u>	<u>S</u>	<u>Lab</u>	<u>Orë javore</u>
1	Teknologjia e sistemeve të kontrollit	5	57	30	19	8	2/1.5/0.5
2	Algoritëm dhe programim i avancuar	6	68	37	23	8	2.5/1.5/0.5
3	Automatika e komandimit industrial	6	62	37	17	8	2.5/1/0.5
4	Metoda numerike për zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale të zakonshëm dhe me derivate të pjeshme	5	60	30	30	-	2/2/0
5	Sensorët dhe instrumentim procesesh I	5	60	37	15	8	2.5/1/0.5
6	Lëndë me zgjedhje (Gr.1)	4	46	23	15	8	1.5/1/0.5
	TOTALI	31	353	194	119	40	

Semestri II (15 javë)

<u>Nr.</u>	<u>Lënda</u>	<u>ECTS</u>	<u>Orë në auditor</u>	<u>L</u>	<u>S</u>	<u>Lab</u>	<u>Orë javore</u>
1	Kontrolli i sistemeve mekatronike	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
2	Teoria e sistemeve dinamike	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
3	Teoria e sistemeve mekanike	4	46	30	8	8	2/0,5/0,5
4	Sensorët dhe instrumentim procesesh 2	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
5	Përafrimi i ekuacioneve diferenciale me derivate të pjesshme e me diferenca të fundme	5	60	30	30	-	2/2/0
6	Elektronika e fuqisë	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
TOTALI		29	346	208	98	40	

Viti i dytë**Semestri I (12 javë)**

<u>Nr.</u>	<u>Lënda</u>	<u>ECTS</u>	<u>Orë në auditor</u>	<u>L</u>	<u>S</u>	<u>Lab</u>	<u>Orë javore</u>
1	Inteligjenca artificiale	4	45	30	15	-	2,5/1/0
2	Robotika	4	45	30	15	-	2,5/1/0
3	Menaxhim projektsh	4	36	23	13	-	2/1/0
4	Teknologji mekanike	4	45	37	8	-	3/0,5/0
5	Kontrolli dixhital	4	46	30	8	8	2,5/0,5/0,5
6	Lëndë me zgjedhje (Gr.2)	4	46	30	8	8	2,5/0,5/0,5
7	Praktika mësimore	6	-	-	-	-	3 javë
TOTALI		30	263	180	67	16	

Semestri II (15 javë)

<u>Nr.</u>	<u>Lënda</u>	<u>ECTS</u>	<u>Orë në auditor</u> (konsultime pedagogët, bibliotekë, konsultim burimesh)	<u>Orë jashtë auditorit</u> (përgatitja e tezës)	<u>Orë gjithsej</u>
1	Teza e diplomës	30	100	650	750

Lëndë me zgjedhje:**Grupi 1:** Mikroelektronika; Mikromekatronika**Grupi 2:** Projektim sistemesh kontrolli; Modelim dhe simulim i sistemeve mekatronike

Në Aneksin 3, tabela 12 jepet plani mësimor i lidhur me personelin mësimdhënës përkatës.

Syllabuset jepen për çdo lëndë. Elementët që përmban një syllabus janë:

Emërtimi i lëndës/modulit dhe kreditet totale të tij

Viti/semestri kur zhvillohet lënda

Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën

Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit

Autoriteti miratues: Titullari i lëndës; përgjegjësi i departamentit



Kompetencat që fiton student nga kjo lëndë

Temat që trajtohen në lëndë në formimin teorik (Leksione) dhe praktik (Seminare/Ushtrime/Laboratore)

Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit

Format e vlerësimit të studentëve

Detyrimet e studentit për lëndën

Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Në syllabuse nuk jepen: Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës

Ndarja e krediteve sipas aktiviteteve të mësimdhënjes për lëndën

Rekomandohet që syllabuset të plothësohen me njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës.

Për të patur një vlerësim sa më objektiv të cilësisë së syllabuseve, jemi konsultuar me ekspertë të tjerë të fushave përbërëse të mekatronikës.

Në gjykimin e përgjithshëm mund të themi se syllabuset janë të lidhura me fushën e Inxhinierisë Mekatronike dhe japin njohuri më të thelluara dhe specifike në formimin e inxhinjerit mekatronik. Përmbajtja e syllabuseve është e lidhur edhe me formimin bazë të marrë në ciklin e parë të Bachelorit në Inxhinieri Mekatronike. Kjo ka bërë që në disa lëndë të zhvillohen tematika që japin njohuri bazë të fushës, që kanë munguar në programin e studimit Ba në Inxhinieri Mekatronike". Këtu futen programet e lëndëve "Metodat numerike për zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale të zakonshëm dhe me derivate të pjesshme", programi i të cilës duihet të zhvillohet që në ciklin e parë për t'u aplikuar në zhvillimin e disiplinave të tjera; "Elektronika e fuqisë", në të cilën studenti merr njohuri bazë dhe nuk fiton shprehi projektuese; teoria e sistemeve mekanike, në të cilën jepen njohuri bazë të formimit mekanik të inxhinjerit; "Teknologji mekanike", ku merret informacion i përgjithshëm për teknologjinë e përpunimit mekanik. Në të gjitha këto lëndë, niveli i thellimit nuk ngrihet në atë teoriko-shkencor apo zhvillues-projektues që kërkon niveli i kualifikimit në ciklin e dytë "Master i Shkencave". Përveç kësaj në mungesë të deklaramit për çdo lëndë të njohurive paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e saj, ka lëndë, ku për tematikat e zhvilluara studenti nuk ka njohuritë paraprake për zhvillimin e tyre, si p.sh. në lëndët "Automatika e komandimit Industrial" studentit i mungojnë njohuritë për makinat elektrike speciale dhe transmisionet elektrike të automatizuara. Në lëndën "Mikromekatronika, temat e leksioneve janë shumë të ngjeshura për t'u trajtuar në thellësi për orët e vëna në dispozicion. Në lëndën "Teoria e sistemeve dinamike" duhet të trajtohen më në thellësi problemet e dinamikës së sistemeve mekatronike dhe jo ato të sistemeve elektrike apo makinave elektrike. Lëndët, ku është e mundur, duhet të kenë orientim drejt formimit të shprehive projektuese. Kjo duhet të reflektohet jo vetëm në programin e lëndës, por edhe në parashikimin e projekteve apo detyrave të kursit, gje që është parashikuar vetëm në dy lëndë: "Automatika e komandimit industrial" dhe "Menaxhim Projektesh". Orët e lëna në dispozicion për punët laboratorike janë të pamjaftueshme për zhvillimin e tyre. Në disa raste terminologjia e përdorur nuk është korrekte ose janë lënë në gjuhë të huaj, si p.sh. në lëndën "Teoria e sistemeve mekanike", ku termi fërkim (attrito) përdoret "shtypje", apo termi "camme" (gungë) nuk përkthehet fare.

Raporti ndërmjet lëndëve bazë në formimin e inxhinierit Mekatronik mbetet i disbalancuar, dhe për më tepër, njohuritë e marra në fushën e inxhinierisë mekanike janë të nivelit të ciklit të parë.

Stafi akademik i përfshirë në mësimdhënje ka kualifikimin e kërkuar për të dhënë mësim në ciklin e dytë (të paktën gradën "Doktor"), por anagazhimi i një pjese të tyre si mësimdhënës në ndonjë lëndë nuk është bërë në përputhje me fushat e tyre të kompetencës të fituara gjatë diplomimit apo kualifikimit si DR. Këtë e konstatojmë për lëndët "Algoritëm dhe programim i avancuar", ku pedagogu nuk është në fushën e Inxhinierisë Informatike, apo Informatikë; Automatika e

komandimit Industrial, ku pedagogu nuk është i fushës së automatizimit, Teoria e sistemeve dinamike, ku pedagogu është i fushës së mekanikës dhe programi i lëndës merret me dinamikën e sistemeve elektrike apo makinave elektrike.

Titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë së profesorit, por shpesh kompetenca e tyre nuk ka lidhje me fushën e disiplinës përkatëse. Për më tepër që të gjithë ishin personel akademik jo efektiv dhe një pjesë e tyre nuk janë tashmë as personel akademik me kontratë.

Rekomandohet që programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronikë të riorganizohet. Nisur nga deklaratimet e stafit akademik dhe atyre të studentëve se “mënyra e zhvillimit të lëndëve orientohej më shumë drejt aplikimit në praktikë të koncepteve dhe njohurive, si dhe cilësisë në hyrje të studentëve, sugjerojmë që për studin aktual do të ishte më mirë organizimi i një masteri profesional në fushën e Inxhinierisë Mekatronike, i cili do të ishte më me interes për tregun e punës.

Dokumentacioni i marrë në institucion është hedhur në sistem

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në Inxhinieri Mekatronike kalon për herë të parë procedurat e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit. Programi i studimit është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Për të dy vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë 120 kredite</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një</p>	<p>Me anë të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike studenti karakterizon dhe kompletton profilin e tij me një sërë kompetencash bazë të teknologjisë si dhe me kompetenca specifike të fushës së mekatronikës.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike synon të krijojë një figurë profesionale me njohuri teorike e praktike më të thelluara në këtë fushë, të aftë për t’u bërë pjesë e tregut të punës. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike synon të zgjerojë njohuritë bazë të marra nga të diplomuarit në programin <i>Bachelor</i>.</p> <p>Nuk ofrohen programe të integruara.</p> <p>Megjithëse këtij programi studimi i është dhënë licensimi me kusht për të vendosur një raport te</p>

<p>profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>balancuar midis fushave baze të formimit: mekanikes, elektronikës, elektroteknikes, informatikes, nga institucioni nuk na u vu në dispozicion ndonjë dokument që të demonstronte përmiresimin e këtij raporti.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike në tërësinë e tij jep njohuri të thelluara në disa drejtime, por nuk krijon bazë të qëndrueshme për studimet e ciklit të tretë doktoraturë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat formues për programin e studimit nuk i përgjigjen qëllimit të një programi studimi të nivelit Master i Shkencave. Ato afrohen më shumë me një Master Profesional. Megjithatë në disa disiplina karakterizuese, syllabuset janë të një niveli të lartë teorik, në përputhje me synimet dhe objektivat formuese që duhet të ketë një program studim Master i Shkencave, implementimi i tyre në praktikë, nga bashkëbisedimi me studentët dhe me stafin akademik bëhet duke i thjeshtësuar argumentet në aspektin aplikativ për t'i bërë më të kuptueshëm nga studentët. Kjo kushtëzohet edhe nga formimi bazë teorik i studentëve që kanë hyrë në këtë program studimi.</p> <p>Kontrolli i vazhdueshëm i studentëve dëshmon ecurinë dhe arritjet e tyre për ciklin përkatës të studimeve.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimin në to metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjisacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në Inxhinieri Mekatronike është hartuar duke u mbështetur në përvojën e marrë nga universitetet në Itali.</p> <p>Adaptimi i praktikave Europiane e bën programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Mekatronike konkurrues në nivel kombëtar. Gjithashtu ky program është hartuar në përputhje me deklaratën e Bolonjës.</p> <p>Programi i studimit tenton të arrijë objektivat në lidhje me nivelin e kualifikimit që duhet të arrihet në përfundim të tij.</p>

profesionet e rregulluara.	
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Sipas dokumentacioni, plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Mekatronike parashikon në semestrin e dytë të vitit të dytë praktikë profesionale.</p> <p>Gjithashtu në të përfshihen edhe disa të lëndë me karakter aplikativ. Në shumicën e lëndëve janë parashikuar laboratore, të cilat janë në funksion të aftësimin profesional të studentëve.</p> <p>Në lëndët dhe modulet e formimit karakterizues duhet të përfshihen projekte ose detyra kursi, për të rritur kompetencat projektuese në dalje të studentëve. Personeli akademik i përfshirë angazhohet në punë kërkimore.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	N/A
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; • kërkesat e punëdhënësve; • një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; • numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit Msc. Inxhinieri mekatronike merr parasysh nevojat e tregut të punës, dhe është hartuar në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>AU ka bere nje vlerësim te tregut të punës. Departamenti i Inxhinierisë ka kryer një studim te tregu për programet e studimit inxhinjerike që ofron, i cili përfshin mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas .</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>AU ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtar dhe synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30 kredite europiane ECTS për tezën finale që përgatitet në përfundim të këtij programi studimi. Kohëzgjatja normale e tij është 2 vite akademike;</p>
---	--

Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.

N/A

Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).

N/A

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;

Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Departamenti i Inxhinierisë jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimeve Msc Inxhinieri Mekatronike, lëndët dhe syllabuset, në fillim të çdo viti akademik, nëpërmjet pedagogeve, sekretarisë mësimore, zyrës së karrierës, website. Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar.

Për realizimin e programit të studimeve Msc. Inxhinieri Mekatronike janë parashikuar 30 kredite për tezën

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga departamenti dhe takimi me drejtuesit e Departamentit të Inxhinierive, përgjegjës për programin e studimit Msc në Inxhinieri Mekatronike si dhe nga takimi me stafin akademik, rezultoi se njësisia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi jep informacionin e nevojshëm për studentët dhe të interesuarit e tjerë për programin e studimit, si dhe disponon dokumentacionin e nevojshëm të plotë për informim si program studimi, plan mësimor, syllabuse

lëndore, etj. Çdo fillim semestri studenteve u vihen në dispozicion kalendari dhe llojet e lëndëve që do të zhvillohen. Programi i studimit Msc. në Inxhinieri Mekatronike përshtatet me ciklin e dytë të studimeve.

Mbështetur në analizën e mësipërme, GVJ rekomandon:

- 1. Objektivat formues për programin e studimit t'i përgjigjen nivelit Master i Shkencave. Ato afrohen më shumë me një Master Profesional.**
- 2. Thelësia e trajtimit të argumentave në mësimdhënje t'i përgjigjet nivelit të kualifikimit që duhet të arrijë një program studimi Master i Shkencave.**
- 3. Te kushtohet kujdes në kriteret për pranimin e studentëve në këtë program studimi, sidomos të atyre që vijnë nga programe studimi të përafërta.**
- 4. Të kushtohet kujdes në përzgjedhjen e lëndëve të formimit karakterizues, duke respektuar raportet midis formimeve kryesore të Inxhinierit Mekatronik.**
- 5. Brenda të njëjtit plan mësimor konvertimi i kreditit në orë në auditor për të gjitha format e studimit rekomandojmë të jetë i njëjtë. Të përcaktohet mënyra e konvertimit të krediteve të ushtrimeve/projekteve në orë në auditor. Praktika profesionale të konsiderohet orë në auditor për studentin, pasi ajo kryhet nën mbikqyrjen e pedagogut apo të një specialisti të kompanisë ku kryhet praktika.**
- 6. Syllabuset të plothësohen me njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës.**
- 7. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronikë të riorganizohet. Nisur nga deklaratimet e stafit akademik dhe atyre të studentëve se "mënyra e zhvillimit të lëndëve orientohet më shumë drejt aplikimit në praktikë të koncepteve dhe njohurive, si dhe cilësisë në hyrje të studentëve, sugjerojmë që për stadin aktual do të ishte më mirë organizimi i një masteri profesional në fushën e Inxhinierisë Mekatronike, i cili do të ishte më me interes për tregun e punës dhe për prurjet e studentëve që ka AU.**
- 8. Angazhimi në mësimdhënje i stafit akademik të jetë në përputhje jo vetëm me nivelin e kualifikimit, por edhe ekspertizën teknike të pedagogut.**

Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Procesi mësimor është i organizuar në vite akademike. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon deri në 23 orë mësimore në auditor/javë. Mësimi zhvillohet pasdite, meqenëse pjesa më e madhe e styre ish-in të punësuar. Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati. Format e mësimdhënies: Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, labororet, detyrat ose projekte kursi, praktikat profesionale. Numri total i veprimtarive formuese është 20, ku janë parashikuar 18 provime, 1 praktikë dhe punimi i diplomës. Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur. Kontrolli i dijës së një lënde bëhet me cikle , si rregull, bëhet me shkrim, me gojë, me praktike ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje. Njohuritë e përfituara nga studenti, kontrollohen dhe vlerësohen përmes një kombinimi të frekuencimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimin në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe provimit me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lënde bëhet me pikë, deri 100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi

maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Modulet, provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e moduleve dhe të provimeve shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sesionit.

Metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjegimit në tabelle me projektme të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve. Stafit akademik dhe procesi mësimor janë në vlerësim periodik nga ana e studentëve si dhe në kontrollin e departamentit. GVJ e evidentoi këto vlerësime gjatë takimeve me drejtuesin e departamentit, stafin akademik dhe studentët.

Studentët kishin marrë pjesë në konferencën shkencore studentore, të organizuar nga AU.

Ngarkesa totale në orë e këtij programi studimi, sipas formave të mësimdhënjes jepet në tabelën e mëposhtme:

Programi i Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	582
b.	Seminare	8
c.	Ushtrime	273
d.	Laboratorë	96
e.	Detyra Projekte	3
f.	Teza e diplomës	100
Në total		1062

Vlerësimi realizohet sipas metodologjisë së mëposhtme:

Programi i Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike		
Format e kontrollit		Sa pjesë e vlerësimit total të studentit ka
a.	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	20 %
b.	Testimet gjatë vitit	20 %
c.	Provimet përfundimtar	60 %
Në total		100 %

Studentët

Pjesa përshkrimore

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se në vitin akademik 2015-2016 janë regjistruar 10 studentë, me notë mesatare të programit *Bachelor* të përfunduar 6. Kanë kaluar në vitin pasardhës 10 studentë. Nga brezi 2015 – 2016, nga 10 studentë, 7 studentë i kanë marrë të gjitha provimet, 1 student ka 9 provime për të shlyer, 1 student ka 4 provime për të shlyer dhe 1 student ka 1 provim për të shlyer. Ky brez përfundon kohën e rregullt të ciklit të studimeve në kuadër të programit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike me mbrojtjen e diplomës në vitin akademik 2016 – 2017.

Në vitin akademik 2016-2017 janë regjistruar 17 studentë, me notë mesatare të programit *Bachelor* të përfunduar 6.1. Nga studentët e regjistruar në MSc në Inxhinieri Mekatronike, në vitin akademik

2016-2017 rezultojnë të punësuar në profiling e tyre, 3 studentë nga viti i parë dhe 6 studentë nga viti i dytë. Të punësuar jashtë profilit janë 2 studentë.

Në këtë program studimi janë pranuar student që vijnë me diplomë Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, por edhe student me diplomë bachelor në inxhinieri elektronike, inxhinieri kompjuterike, inxhinieri mekanike, inxhinieri elektrike, matematikë, navigacion, të lëshuara nga AU, UPT, Universiteti "Kristal", Universiteti i Vlorës, etj. Numri i studentëve të pranuar me diploma jo mekatronikë ka qenë 3 në vitin akademik 2015-2016 dhe 11 në vitin akademik 2016-2017. Në të dy vitet akademik është ngritur komisioni i ekuivalentimit, që përbëhej nga këta persona:

Viti akademik 2015-2016: Hivzi Muharremi, Setki Mulla, Elida Zeqo Miraj. Konstatohet se asnjëri prej tyre nuk ka formim të afërt me Inxhinierinë Mekatronike.

Viti akademik 2016-2017: Remzi Sulo, Setki Mulla, Fatmir Basholli, Amalia Tola, Juljana Strataj. Konstatohet se në këtë komision vetëm 1 anëtar është formim në Inxhinierinë Mekatronike.

Për të gjitha rastet është marrë një vendim për regjistrim direkt në MSc në Inxhinieri Mekatronike pasi programet e studimit bachelor të studentëve kanë ngjashmeri me mbi 70 % me programin e studimit bachelor në Inxhinieri Mekatronike. Konstatohet se vendimi është marrë për të gjithë në bllok, pa parë diferencat në programet që kanë ndjekur. Për më tepër, studentët nuk kanë patur asnjë kredit debi për të marrë nga cikli i parë, bachelor. Ka programe studimi si Matematika (4 vjeçare) e sistemit të vjetër, apo Navigacioni në Universitetin e Vlorës, të cilat nuk kanë ngjashmëri me programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronikë. Në sekretari dhe departament nuk na u vu në dispozicion praktika e ekuivalentimit të lëndëve për secilin student.

Studentët me mangësi në formimin bazë në Inxhinieri Mekatronike, do të kenë probleme në konceptimin dhe thellimin teorik në disipinat e programit të studimit të ciklit të dytë.

Rekomandohet , ne rast se studenti ka diplome bachelor jo te te njejtin fushe ekuivalentimet te behen individuale. Komisioni i ekuivalentimit të përbëhet me personel akademik efektiv nga departamenti i inxhinjerive dhe për rastet e mangësive në formim sidomos në lëndët karakterizuese, që lidhen direkt me programin e studimit të ciklit të dytë, të ngarkohen studentët që të shlyejnë një sasi kreditesh të caktuar nga cikli i parë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e</p>	<p>Studentët që ndjekin programet e studimeve Master i Shkencave ne Inxhinieri Mekatronike zotërojnë së paku diplomën universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga AU.</p> <p>Për rregjistrim në programin e studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike studentet janë të detyruar të paraqesin certifikaten e gjuhës huaj mbi bazën e testeve të njohura ndërkombetare . Ne disa dosje mungonte</p>

<p>integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p>	<p>certifikata e gjuhes se huaj, por institucioni kishte lene nje afat deri ne fund te vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p>AU u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës AU ndjek një politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit. Studentëve u bëhet e njohur informacioni mbi akreditimin e programit që në kontaktin e parë me institucionin.</p>
<p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p>	
<p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	<p>AU disponon statistika për numrin e të diplomuarve dhe studentëve që pritet të diplomohen.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	<p>AU ka statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërhequr dhe largimin para përfundimit të programit dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>AU disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e në vazhdim.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p>	<p>AU po punon për realizimin e një database me të dhënat mbi punësimin e studentëve si gjatë ciklit të studimit ashtu edhe pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>AU aktualisht nuk ka aktivizuar programe studimi të mëtejshëm.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në detaje për programin e studimit, kohëzgjatjen, organizimin e tij, statusin e akreditimit etj.</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Pedagogu diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>AU u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p> <p>AU ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Au ka procedura te përcaktuara për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë. AU nuk kishte kritere në hyrje për cilësinë e pranimeve në Master Shkencor. Cilësia në hyrje në MSc Inxhinieri Mekatronike është e ulët, (nota mesatare 6). Rreth 35% e studentëve janë të punësuar kryesisht brenda profilit. AU po punonte për të ngritur rrjetin e Alumnit. Për momentin nuk kanë dalë akoma të diplomuarit e parë. Zyra e karrierës ndihmonte studentët për orientimin e tyre dhe për dhënje informacion për mundësitë e punësimit.</p> <p><i>Rekomandohet , ne rast se studenti ka diplome bachelor jo te te njejtin fushe ekuivalentimet te behen individuale. Komisioni i ekuivalentimit të përbëhet me personel akademik efektiv nga departamenti i inxhinjerive dhe për rastet e mangësive në formim sidomos në lëndët karakterizuese, që lidhen direkt me programin e studimit të ciklit të dytë, të ngarkohen studentët që të shlyejnë një sasi kreditesh të caktuar nga cikli i parë.</i></p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Politika e kërkimit shkencor të AU në fushat e studimit inxhinjerike, është në funksion të politikës tërësore të universitetit dhe të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Në strategjinë e zhvillimit që miratohet nga Senati i Universitetit theksohet realizimi i kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave specifike të institucionit, në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij, duke krijuar një raport të drejtpeshuar dhe efektiv ndërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor; në krijimin e shprehive dhe të metodave kërkimore shkencore me studentët, duke i aktivizuar ata deri edhe në përfshirjen e tyre në grupet studimore e projekte që kanë departamentet, fakultetet ose universiteti.

Kërkimi shkencor është një element i ngarkesës së pedagogëve në "AU". Tregues të veprimtarisë

kërkimore janë konferencat shkencore, botimet në revista, kërkimet në bashkëpunim me institute apo agjenci kërkimore brenda dhe jashtë vendit, etj. Udhëheqjet e punimeve të studentëve të programeve Bachelor dhe Master janë pjesë thelbësore e cilësisë së stafit pedagogjik kërkimor. Pedagogët kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Nga të dhënat e marra gjatë vizitës, aktiviteti kërkimor shkencor i stafit akademik efektiv i departamentit të inxhinjerive, gjatë periudhës 2011-2016 përmbledhet si më poshtë vijon:

pjesëmarrje në projekte kombëtarë dhe ndërkombëtare:	1;
mobiltet i stafit si kërkues shkencor:	1;
Pjesëmarrje si anëtar i bordit editorial në revista shkencore ndërkombëtare	2;
Çmime kombëtare për punën kërkimore shkencore, patenta të regjistruara brenda ose jashtë vendit	1;
Çmime ndërkombëtare për punën kërkimore shkencore, patenta të regjistruara brenda ose jashtë vendit	1;

Publikime të kryera nga stafi akademik efektiv për vitet 2011-2017 janë si më poshtë:

pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare	35
pjesëmarrje në konferenca kombëtare	21
Publikime në revista kombëtare	15
Publikime në revista ndërkombëtare	17
Botime libra/monografi në shqip	3
Botime libra/monografi në gjuhë të huaj	5

Fakulteti organizon Konferenca shkencore në fusha të caktuar dhe angazhon stafin akademik për të marrë pjesë në to gjithashtu i nxit ata që të mbështesin edhe pjesëmarrjen e studentëve në konferenca të tilla duke i dhënë mbështetjen maksimale profesionale. Në vazhdim të mbështetjes së kërkimit shkencor Universiteti nëpërmjet revistës shkencore "Optime" i mundëson stafit akademik të botojnë artikujt e tyre shkencorë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Stafi akademik angazhohet rregullisht në veprimtaritë të kërkimit shkencor, të cilat janë në përpuethshmëri me disiplinat ku angazhohet.</p> <p>Veprimtaritë janë si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mesimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mesimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mesimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në</p>	<p>Programi i studimit Msc. Inxhinieri Mekatronike zhvillohet në gjuhën shqipe</p>

mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>AU organizon konferenca kombëtare dhe mbështet pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor.</p> <p>AU ofron mbështetje shkencore për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>AU disponon një bazë të dhënash për publikimet e anëtarëve duke identifikuar vitin, autorin, llojin e publikimit etj.</p> <p>GVJ nuk evidentoi pjesëmarrje në projekte kombëtare.</p> <p>Departamenti po bënte përpjekje për të qenë pjesë e projekteve ndërkombëtare nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Stafi akademik angazhohet në veprimtaritë të kërkimit shkencor, të cilat janë në përpuethje me disiplinat e tyre. Universiteti nëpërmjet revistës shkencore "Optime" i mundëson stafit akademik të botojnë artikujt e tyre shkencorë. Universiteti nuk angazhohet drejtpërsëdrejti në kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik, por e mbështet në aktivitetin shkencore dhe akademike që ata kanë si projekte individuale kualifikimi.</p> <p>Rekomandim: AU duhet të rrisë frymën e bashkëpunimit me universitetet brenda vendit dhe përmes pjesëmarrjes në projekte bashkëpunimi në mënyrë që të realizohet më mirë shkëmbimi i informacionit dhe praktikës më të mirë e vlefshme për njohje më të mirë të problematikës dhe situatës në Shqipëri</p>	

Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Albanian University ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Ningbo Dahongying, Kinë, me Universitetin e Corvinus, Budapest Hungari, me Universitetin e L'aquilas. Këto bashkëpunime synojnë që të nxisin zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore, me interes të ndërsjellë, mobilitetin e stafeve, shkëmbime të botimeve, etj.

Departamenti i inxhinjerive ka lidhur edhe një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani shqiptare, për shkëmbime informacioni, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta, kryerje të praktikave profesionale të studentëve, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>AU nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>AU garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave që përcaktohen edhe në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>AU për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas.</p> <p>AU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Kjo dëshmohet me dokumentet e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Institucioni nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e tij të diplomuar.</p> <p>Aktualisht nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale nga Universiteti</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>AU për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas. Marrëveshjet janë në nivel institucioni, nuk mund ti ndajmë ato që kanë lidhje direkte me këtë program studimi.</p>	

GVJ mbështetur në RVB dhe nga takimet nuk përcakton qartë masën e përfitimit të bashkëpunimit për programin Master në Inxhinieri Mekatronike. Kjo për faktin se mungojnë të dhëna dhe raporte analitike në lidhje me këto bashkëpunime.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës **SWOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

Pika të forta:

- Institucioni nga pikëpamja organizative dhe e funksionimit është i konsoliduar. Janë ngritur dhe implementuar organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese të Institucionit dhe njërive vartëse të tij. Janë ngritur dhe implementuar politikat, procedurat dhe mekanizmat për drejtimin e të gjitha aktiviteteve kryesore të punës së Institucionit
- Fakulteti është riorganizuar dhe plotëson kriteret e përcaktuar në ligj.
- Departamenti ka personel akademik efektiv dhe me kontratë si dhe personel mbështetës për të përballuar ngarkesën mësimore të programit të studimit. Përzgjedhja e tyre bëhet me procedura transparente dhe njoftime publike.
- Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit të institucionit.
- Fakulteti i shkencave të aplikuara dhe departamenti i inxhinierive ftojnë si pedagogë me kontratë (PAK) një staf akademik kompetent dhe me kualifikim të lartë. I gjithë stafi akademik i përfshirë në mësimdhënje në këtë program studimi është me gradë shkencore.
- Baza laboratorike është mjaft e mirë dhe bashkëkohore. Ajo mbulon të gjitha punët laboratorike të planifikuara.
- Metodatat e mësimdhënjes janë bashkëkohore; procesi mësimor zhvillohet normalisht, me seriozitet dhe përkushtim.
- Janë ngritur dhe funksionojnë mekanizmat për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënje. Performanca e Stafit akademik vlerësohet rregullisht.
- Institucioni përkujdeset për studentët gjatë viteve të studimit dhe bën orientimin e tyre për në tregun e punës nëpërmjet zyrës së karrierës.

Pika të dobëta:

- Nuk janë marrë në konsideratë të gjitha kushtet e vëna në liçensim.
- Departamenti nuk ka konkretizuar marrëveshjet e lidhura me biznesin për të kryer shërbime dhe projekte bashkëpunimi në fushat inxhinierike.
- Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronikë nuk i përgjigjet mjaftueshëm nivelit të kualifikimit që kërkon një program studimi Master Shkencave; raportet ndërmjet fushave integruese të elektornikës, elektrikes dhe mekanikes nuk janë të mirë-balancuar. Programet e disa lëndëve janë të nivelit fillestar (për programe bachelor), ku mungojnë njohuritë e thelluara teorike.
- Objektivat formuese të programit të studimit nuk i përgjigjen nivelit Master i Shkencave. Thellësia e trajtimit të argumentave në mësimdhënje nuk i përgjigjet nivelit të kualifikimit që duhet të arrijë një program studimi Master i Shkencave. Ky program studimi i afrohet më shumë një Masteri Profesional.

- Koordinator i programit të studimit është pjesë e personelit akademik me kontratë. Mungon komiteti shkencor i programit të studimit.
- Titullarët e lëndëve ishin pjesësrisht anëtarë të personelit akademik me kontratë dhe disa prej tyre aktualisht nuk janë fare pjesë e stafit akademik të departamentit të inxhinierive.
- Në Syllabuset nuk jepen njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës. Kjo ndikon në organizimin e planit mësimor dhe në krijimin e piramidës së dijeve.
- Pedagogët efektiv dhe një pjesë e pedagogëve me kontratë kanë një numër disiplinash një ngarkesë mësimore shumë të madhe.
- Stafi akademik në disa raste është angazhuar në mësimdhënje në disiplina që janë jashtë fushës së tyre të ekspertizës.
- Kriteret në hyrje të studentëve në Msc Inxhinieri Mekatronike nuk i përgjigjen kërkesave dhe objektivave formuese që duhet të ketë një program studimi i Master Shkencor. Studentëve të pranuar nga programe bachelor të përafërta, nuk u përcaktohen detyrime plotësuese për lëndët kryesore karakterizuese të Bachelorit në Inxhinieri mekatronike.
- Departamenti/Fakulteti nuk janë pjesëmarrës në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si në drejtim të zhvillimit të kurrikulave dhe në ndihmë të procesit akademik, ashtu edhe në drejtim të kërkimit dhe zhvillimit shkencor.
- Biblioteka ishte mjaft modeste për drejtimin inxhinierik si në drejtim të literaturës, ashtu edhe për sigurimin e sallave të studimit.
- Mjediset infrastrukturore për akomodimin e stafit akademik efektiv është i kufizuar.

Mundësitë:

- Departamenti i ka burimet për të bërë rishikimin e programit të studimit dhe ta harmonizojë me programin përkatës të studimit të ciklit të parë të rishikuar.
- Institucioni me ndryshimin e politikave të brendshme dhe strategjisë të zhvillimit mund të orientohet më mirë drejt krijimit të të ardhurave nga shërbimet për të tretë dhe jo vetëm nga tarifat e shkollimit.
- Institucioni ka mundësi të zgjerojë marrëveshjet e bashkëpunimit duke i bërë aktive ato edhe në drejtimet inxhinierike.
- Institucioni ka mundësi të përmirësojë shpërndarjen e ngarkesës për pedagogët efektiv, duke ulur kufirin e sipërm të ngarkesës dhe numrin e disiplinave që mban një pedagog, për të krijuar mundësi pjesëmarrje të stafit efektiv në punë kërkimore shkencore.
- Me një rishpërndarje më të mirë të të ardhurave të krijuara, mund të pasurohet biblioteka
- Ofrimi i programeve specifike për kualifikimin e mëtejshëm të personelit të angazhuar.

Pengesat:

- Disa kufizime ligjore pengojnë ndryshimin për përmirësim të kurrikulës, duke e kufizuar në masën deri në 20%
- Vështirësi për realizimin e kualifikimeve (shkollat e doktoraturës) të stafit akademik pa gradë shkencore.
- Vështirësi për të marrë pjesë në programe kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit për shkak të mungesës së kapaciteteve humane.
- Vështirësitë për sigurimin e personelit akademik efektiv me kualifikimin e kërkuar;

SUMMARY ANALYSIS OF THE STUDY PROGRAM IMPLEMENTATION

Summary analysis of the External Evaluation Report according to the SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

Strengths

- Institution is consolidated from an organizational and functional point of view. Collegial bodies and governing authorities of the Institution and its subordinate units have been set up and implemented. Policies, procedures and mechanisms for running all major activities of the Institution have been established and implemented
- The Faculty has been reorganized and meets the criteria set by law.
- The Department has full time and part time academic staff as well as administrative personnel to support the teaching load of the study program. Their selection is done through transparent procedures and public announcements.
- The second cycle study program “Master of Science in Mechatronic Engineering” is in line with the mission and strategic developing objectives of institution.
- The Faculty of Applied Sciences and the Engineering Department invite as a part time lecturer (PAK) a competent and highly qualified academic staff. All the academic staff involved in teaching in this study program has at least scientific degree.
- Laboratory base is quite good and contemporary. It covers all planned laboratory work.
- Teaching methods are contemporary; The teaching process develops normally, with seriousness and dedication.
- Mechanisms for controlling and quality ensuring in teaching have been set up and functioning. The performance of the academic staff is evaluated regularly.
- The institution takes care of students during the study years and guide their orientation to the job market through the career office.

Weaknesses

- All conditions set out in the license have not been taken into consideration.
- The Department has not implemented business-related agreements to perform services and cooperation projects in engineering fields.
- The Curriculum of the Master of Science in Engineering in Mechatronics Engineering does not sufficiently correspond to the qualification level of the “Master of Science” study program; The relationships between integrating fields of electronics, electrics and mechanics are not well-balanced. Some subjects syllabuses are at the initial level (at bachelor qualification level), with lacking in-depth theoretical knowledge.
- The forming objectives of the study program do not correspond at the Master of Science’s qualification level. The theoretical depth of the argument in teaching does not correspond to the level of qualifications that a Master of Science’s Degree Program. This study program is closer to a Professional Master.
- The study program coordinator is part of part time academic staff. There is no scientific committee of the study program.
- The subject head were partially members of part time academic staff and some of them are currently not part of the academic staff of the engineering department.



- The Syllabus does not give you the background knowledge the student needs to acquire for the subject. This affects in organizing the teaching plan and creating the basement knowledge.
- Full time academic staff and a part of part time academic staff have a number of subjects and a large of working load in class.
- Academic staff in some cases have been engaged in teaching in disciplines that are not including in their field of expertise.
- The admission criteria at Msc Mechatronic Engineering do not meet the requirements and the training objectives that a Master's degree program should have. Students admitted by other bachelor programs do not have the obligation to complete the basic knowledge from the main characterizing subjects of Bachelor in Mechatronic Engineering.
- The Department / Faculty are not involved in various national and international projects, both in terms of curricula development and assisting the teaching process as well as research and scientific development.
- The library was quite modest for engineering, both in terms of literature and in providing study halls.
- Infrastructure for accommodating effective academic staff is limited.

Opportunities

- The Department has the resources to review the study program and align it with the relevant reviewed study program of the first cycle.
- The institution based on changing the internal policy and development strategy can be better oriented towards creating income from third-party services and not just from tuition fees.
- The institution may expand cooperation agreements by making them active in engineering fields.
- The Institution can improve the teaching load distribution for full time academic staff by reducing the upper limit of the teaching load and the number of disciplines held by a lecturer to provide the participation of effective academic staff in research.
- With a better alocation of generated incomes, the library can be enriched in books and reviews.
- The institution can provide specific programs for further qualification of engaged personnel.

Threats

- Some legal restrictions impede the curriculum improving changes, limiting it up to 20%.
- Difficulties in achieving qualifications (doctoral schools) of academic staff without scientific degrees.
- Difficulties in participating in national and international research and development programs due to lack of human capacity.
- Difficulties in providing effective academic staff with the required qualification;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof.Asoc.Dr.Mimoza Cukalla

